

VENDIM
Nr. 48, datë 31.1.2018

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 250, DATË 24.4.2003, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, 10 e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, përmasat e pronës, me emërtimin “Qendra e Shërbimit dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit”, zëvendësohen me përmasat e përcaktuara sipas formularit me 1 (një) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Qendra e Shërbimit dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te vecanta)


Institucioni Qendror: **Ministria e Punëve të Brendshme**
Qendra e Sherbimit dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit

Identifikoi: **Besnik Çina** (Drejtor i Programit të Buxhetit dhe Finances)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Bashkia Tirane

Aprovoi **Vait Sinaj** (Drejtor i Përgjithshëm në QSHAMT)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Fusha e përdorimit të Pronës: Sherbime



		A		B		C					
Nr. Rend	Nr. Rend sipas VKM	Zona Kadastr. Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Emertesa e Prones Vend ndodhja / Shtirija Gjeografike	Komponentet perberes te Prones	Adresa/Vend ndodhja e komponenteve perberes	Permasat e Prones ne m ²	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni/Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni/Enti perdonues Statusi juridik i perdonimit	Te dhena te tjera (Shenime te vecanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	
1				QSHAMT (ish ofcina e MB)		Rruga Irfan Tomini Tirane	9825.54 m2		MPB	QSHAMT	
2				Rruga Irfan Tomini Tirane	Godine 1 kat	Pike referimi	1315.78	Rep riparim vetura+furgona	MPB	QSHAMT	
3					Godine 2 kat	Veti	322.8	Zyra+Magazina	MPB	QSHAMT	
4					Godine 1 kat	Lindje	521.43	Rep Kamionave	MPB	QSHAMT	
5					Godine 1 kat	Jug - Perendim	161.7	Repart	MPB	QSHAMT	
6					Godine 1 kat	Veti - Perendim	879	Repart+magazine	MPB	QSHAMT	
7					Godine 1 kat	Jug	446.86	Lokal	MPB	QSHAMT	
8					Godine 1 kat	Lindje	309.5	Magazine	MPB	QSHAMT	
9					Godine 1 kat	Jug-Lindje	532.7	Rep Motorist	MPB	QSHAMT	
10					Truall i lire	Perendim	2859.84	Truall i lire	MPB	QSHAMT	
11					Truall i lire	Lindje	1228	Truall i lire	MPB	QSHAMT	
12					Truall i lire	Veti	1247.93	Truall i lire	MPB	QSHAMT	